

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjedhjet në Gjermani vënë në provë Merz, tronditet ekuilibri politik
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/zgjedhjet-ne-gjermani-vene-ne-prove-merz-tronditet-ekuilibri-politik-i586861
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:19:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	750d40c6933045705c87d9b74a18bc99a87d00878af5e8cc85192226dd30d837
TEKSTI	0ea1fe96f0ef8ae3a5b2dd718edda174657a8f546a81c4d8f91565dc305b00c4
PAMJA	07da004178bbc6438b232febb6a0242e4dd7cbb823ccf0c017fe51489f771fd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	11870e7e309091da2c2e2493a536cb924c84ffff1755f6653ec6bad9169331d38
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/11870e7e309091da2c2e2493a536cb924c84ffff1755f6653ec6bad9169331d38>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Skender Gjinushi priti ne takim zyrtar drejtorin e pergjithshem te CIHEAM-Barri, dr. Biagio Di Terlizzi](#) [Denimi i ish-krereve te UÇK, protestuesit zbulojne 4 kerkesat](#) [Shtuqi fundit](#)

Zgjedhjet në Gjermani vënë në provë Merz, tronditet ekuilibri politik



18 Shtator 2026, 14:00 Bota TEMA



Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe në landin Meklenburg-Pomerani Perëndimor pritet të jenë një provë e rëndësishme për kancelarin gjerman Friedrich Merz dhe partinë e tij, CDU. Sondazhet tregojnë rënie të ndjeshme të mbështetjes për kristiandemokratët, ndërsa Alternativa për Gjermaninë (AfD) po shënon rritje.

Në Meklenburg-Pomerani Perëndimor, CDU parashikohet të marrë vetëm rreth shtatë % të votave, ndërsa AfD renditet shumë më lart, me rreth 37%. SPD, e drejtuar nga kryeministria e landit Manuela Schwesig, ndodhet rreth 35%, ndërsa Die Linke rreth 10% dhe të Gjelbrit rreth pesë %.

Edhe në Berlin situata nuk është e favorshme për CDU-në. Sondazhet e fundit e vendosin partinë mes 15 dhe 20%, rreth nëntë pikë më pak krahasuar me vitin 2023. AfD llogaritet rreth 18 për qind, ndërsa SPD rreth 12%. Die Linke shkon në rreth 20% dhe të Gjelbrit në 16%.

Rënia e CDU-së ka shtuar diskutimet për të ardhmen politike të Merz. Politologja Ulrike Guerot thotë se brenda partisë ekziston shqetësimi se CDU mund të mos arrijë pragun prej 5% në Meklenburg-Pomerani Perëndimor, çka do ta nxirrte nga parlamenti rajonal. Sipas saj, një rezultat i tillë do të ishte një goditje e madhe për partinë.

Merz ka anuluar pjesëmarrjen e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork dhe ka thirrur një takim urgjent të drejtuesve kryesorë të CDU-së për mbrëmjen e së dielës, kur priten rezultatet e para të zgjedhjeve.

Në parti kanë nisur gjithashtu diskutimet për atë që mund të ndodhë pas zgjedhjeve. Zyrtarisht nuk flitet për zëvendësimin e Merz, ndërsa brenda CDU-së përmenden emra të tjerë si Daniel Günther dhe Hendrik Eüst. Megjithatë, 11 kryeministra të landeve të drejtuara nga kristiandemokratët kanë publikuar një deklaratë në mbështetje të kancelarit.

Markus Söder, kreu i CSU-së bavareze, ka paralajmëruar se një krizë brenda CDU-së do t'i shërbente AfD-së. Brenda partisë, Merz po përballlet me kritika nga

dy krahë: disa e akuzojnë se nuk po mban një qëndrim mjaftueshëm të fortë ndaj AfD-së, ndërsa të tjerë e kritikojnë për afrimin me këtë forcë politike.

Ekspertët e shohin situatën si një pasqyrim të pasigurive politike në Gjermani. Politologia Ursula Münch thotë se disa zëra brenda CDU-së po flasin për një krizë të mundshme, ndërsa ajo u bën thirrje politikanëve të moderuar të ruajnë qetësinë.

Në Berlin, zgjedhjet kanë një rëndësi të veçantë edhe për postin e kryebashkiakut. Nëse CDU humbet, posti mund të kalojë te Elif Eralp, kandidate e Die Linke, nëse kjo forcë siguron mbështetjen e SPD-së dhe të Gjellbëve. Eralp, vajza e aktivistëve sindikalistë turq, është bërë një nga figurat e fushatës së majtë, e cila është fokusuar kryesisht te çështja e strehimit dhe situata në Gaza.

Në Meklenburg-Pomerani Perëndimor, beteja kryesore pritet të zhvillohet mes AfD-së dhe SPD-së së Manuela Schëesig. Kjo e fundit kërkon të ruajë drejtimin e landit dhe paraqitet si një nga pengesat kryesore ndaj zgjerimit të së djathtës ekstreme në lindje të Gjermanisë.

Rezultatet e së dielës pritet të japin një sinjal të rëndësishëm për forcën e CDU-së dhe për pozicionin e Merz brenda partisë. Për shumë votues, zgjedhjet shihen edhe si një test për drejtimin që po merr politika gjermane dhe për rritjen e AfD-së.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

OKB: SHBA-të dysohen për krime lufte në Iran

13:00 Bota

Qeveria australiane thyen heshtjen për "ëndrrën" e anëtarësimit të asociuar në BE

12:40 Bota

[NYT: Trump po shqyrton marrëveshje tregtare me Putinin përpara përfundimit të luftës](#)

11:50 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.